



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1610/2 prot

Datë 11.07.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës*”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK
Njësia bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Florfarma” SHPK

Lagjja “Prush”, Ndërtese 3 katëshe, kati 1-rë, kati 2-të me sipërfaqe 80 m2 dhe kati i 3-të - Prodhim i barnave, Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.39/11, Florfarma 1, Vaqarr, Tiranë

Operatori ekonomik “RSM Company” SHPK

Çagllavicë, P.N, Prishtinë, Kosovë

Në datën 10.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3254, si dhe nr. protokollit 1610/2023 datë 10.07.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës*”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK, si dhe me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashi-kohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK.

Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas Pikës 1 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit sipas shtojcës 1 dt.01.06.2023, pasi operatori “VLERA” sh.p.k pajisut me NIPT nga organet tatimore në Kosovë me nr. 81OI98772 nuk ka paraqitur Liçencën për kategorinë II.8.B. Në zbatim të nenit 88, të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, kushti për licensën është i*

detyrueshëm për seicilin nga antarët e bashkimit të operatorëve pasi kapacitetet teknike duhet të vërtetohen nga sicili antar në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Gjithashtu operatori i huaj në këtë rast VLERA sh.p.k nuk mund të kryejë shërbime të dezinsketimit në territorin e Republikës së Shqipërisë me licensën e lëshuar në Kosovë por detyrimisht duhet të ishte paisur me Liçencën për kategorinë II.8.B, sipas shtojces 1 të DST dhe Legjislacionit në fuqi, përpara paraqitjes të ofertës në formën e bashkimit të OE.

- Nga bashkimi i operatorëve "EGIAN MED" sh.p.k dhe "VLERA" sh.p.k në Kontratën e Bashkëpunimit midis operatorëve është deklaruar ndarja e punëve përkatësisht: "VLERA" sh.p.k merr përsipër 39% të punëve dhe "EGIAN MED" sh.p.k 63% të punëve. Ndërkohë në zërat e vlerave të deklarauara në tabelën e ndarjes së punëve, shifrat e deklarauara nga përfitimi i ndarjes së punëve sipas zërave janë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga kontrata e bashkëpunimit, pasi rezulton se "VLERA" sh.p.k do të kryjë 27% të ofertës dhe "EGIAN MED" sh.p.k të 73% ofertë.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "Florfarma" SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik "Florfarma" SHPK, të kriterëve si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ose dokumentin e rregjistrimit vetëm në rastin e produkteve biocide në një prej vendeve e percaktuara në Ligjin 95/2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik".
- Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide që do të kryhet shërbimi objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Eëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë etiketat/katalogët/skemat teknike dhe Dokumentin e të dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet biocide ose jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip dhe anglisht.

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike për Lotet 1, 2, 4, 5

I. Të dhëna të përgjithshme

Procesi i dezinfektimit të mushkonjave do të bazohet në një program parandalimi dhe kontrolli, i cili synon uljen e dendësisë së mushkonjave në zonat e përzgjedhura nëpërmjet kontrollit të larvave me larvicide dhe/ose barriera fizike, apo nëpërmjet eliminimit të vatrave të zhvillimit të mushkonjave në fazën ujore.

Avantazhet që paraqet kontrolli në fazën ujore:

- *larvat kapen më lehtë pasi ato nuk mund të largohen nga vendi i zhvillimit /vatra me ujë;*
- *larvat brenda vatrës ose zonës me ujë qëndrojnë të izoluara aty për një kohë relativisht të gjatë (nga 7 deri në 14 ditë);*
- *mund të trajtohen në çdo kohë;*
- *në një zonë të vogël, të kufizuar mund të jenë të përqendruara një numër i madh larvash;*
- *efekti i larvicideve ka një kohëzgjatje të madhe krahasuar me adulticidet: larvave të sapoçelura nga vezët, u nevojiten zakonisht mesatarisht deri në dy javë që të realizojnë plotësisht ciklin e tyre të zhvillimit në ujë dhe të dalin në fluturim, periudhë në të cilën larvicidi vazhdon efektin e tij, ndërsa aplikimi i adulticidit mund të jetë i nevojshëm të përsëritet brenda 24 orëve, për shkak të emigrimit të mushkonjave në territorin përreth.*

Sipërfaqet që do të trajtohen do të jenë vatra të përhershme dhe/ose të përkohshme, me ujë dhe me larva të mushkonjave në laguna, parqe kombëtare dhe publike, kanale, pellgje, zona urbane hapësira publike dhe private, puseta, bodrume, gropa septike, etj. Trajtimet do të kryhen bazuar në specifikimet teknike, gjetjet dhe konfirmimet e pranisë së larvave në terren me anë të monitorimit entomologjik, para çdo trajtimi.

Në zonat urbane shqetësim përbëjnë kryesisht mushkonjat e gjinisë Aedes dhe Culex të cilat njihen edhe për rolin e tyre vektorial në transmetimin e patogjenëve si virusin e Nilit Perëndimor (ËNV), virusin Chikungunja, Dengue, ZIKA etj. ndërsa në zonat bregdetare gjithashtu edhe ato të gjinisë Anopheles (vektor të malarisë), Aedes (Ochlerotatus) që shkaktojnë shumë bezdisje me pickimet e tyre sidomos në muzg, etj.

II. Llojet e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave dhe specifikimet teknike sipas habitateve

- A.** *Trajtime periodike me larvicide në Zona të Mbrojtura Natyrore (ZMN) vatra të përkohshme dhe të përhershme në laguna, parqe, kanale, pellgje etj, sipas zonave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.*

Trajtimet kryhen, në periudhën Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhë kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh/vit, me kërkesë të AK.

Çdo cikël trajtimi në habitatet e mësipërme të përfundojë brenda 48 orëve nga data e fillimit, për të shmangur daljen në fluturim të adulteve të llojeve të mushkonjave që zhvillohen në këto habitate.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës do të përcaktohet nga AK për çdo trajtim.

Vendet potenciale të shumimit të larvave të mushkonjave ku nuk konfirmohet prania e larvave apo të cilat janë të thata nuk duhet të trajtohen.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Në vatrat e përhershme të zhvillimit të larvave, inspektimi para trajtimit duhet të bëhet çdo dy javë. Në vatrat e përkohshme të shumimit të larvave, inspektimi duhet të bëhet brenda 24-48 orëve pas reshjeve, baticës ose përmbytjeve natyrore/artificiale.

Për trajtimin e lagunave, parqeve, kanaleve, pellgjeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën ëeb-GIS në kohë reale vendndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën ëeb-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitude, longitude) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit. Shërbimi kryhet gjatë orëve të ditës.

✓ Produktet larvicide që duhet të përdoren

Shërbimi i dezinfektimit në habitatet e mësipërme përfshin zonat bregdetare dhe urbane. Lagunat bregdetare të vendit tonë janë zona të mbrojtura natyrore nga konventa kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të gjithë kanalet që trajtohen në zonën bregdetare derdhen drejtpërdrejt ose indirekt në det.

Produktet larvicide që duhet të përdoren për trajtimin e habitateve të mësipërme nuk duhet të jenë toksike/të rrezikshme për organizmat ujorë dhe tokësorë jo target dhe nuk duhet të jenë të dëmshëm për njerëzit, kafshët, dhe mjedisin, dhe me efikasitet jo më pak se sa dy javë. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe në etiketë.

*Në zonat e mbrojtura natyrore, për të ruajtur mjedisin e ndjeshëm pranohet vetëm përdorimi i produkteve larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.), ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose ekuivalent, me kusht që ekuivalenti të mos dëmtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike.*

Në vatrat ujore që janë të mbuluara me shumë bimësi depërtimi i formulimeve lëng mund të pengohet nga bimësia. Në këto kushte, të përdoret formulim në gjendje të thatë (ose Granula), i cili depërton bimësinë duke arritur deri në vatrën ujore.

Në vatrat ku është e vështirë të kryhet trajtimi nga toka, mund të kryhen aplikime nga ajri.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid biocid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin, organizmat ujorë e tokësorë jo target dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara, duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të

ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;
- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

B. Trajtime periodike me larvicide në puseta dhe bodrume me ujë.

Trajtimet kryhen në periudhën nga Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhe kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh, me kërkesë të AK.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës përcaktohet nga AK.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë, kryhet një herë në muaj, sipas zonave të përcaktuara nga AK.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë të përfundojë brenda një periudhe 2-3 ditore nga momenti i fillimit të trajtimit (vetëm në rast se përcaktohet ndryshe nga AK).

- Gjatë trajtimit të pusetave OE duhet të mbajë aparatën GPRS vazhdimisht të ndezura dhe në gjendje funksionale gjatë kryerjes së shërbimit për transmetimin në platformën ëeb-GIS të dhënave (apicall) që gjenerohen, lidhur me vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik latitude, longitude) gjatë realizimit të shërbimit.
OE është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave të gjeoreferencuara dhe përshtatjen e tyre për ngarkimin në strukturën e të dhënave të standardizuara në platformën ëeb-GIS.
- Për trajtimin e bodrumeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën ëeb-GIS në kohë reale vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën ëeb-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitude, longitude) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;

- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Efekti i pritshëm i shërbimit në bodrume dhe puseta me ujë duhet të jetë jo më pak se katër javë.

✓ **Produktet larvicide që duhet të përdoren**

Bazuar në sa më sipër për trajtimin e pusetave dhe bodrumeve rekomandohet të përdoren produkte larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose barriera fizike njëstresore ose ekuivalent me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën katër javësh në habitatet specifike. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe/ ose në etiketë, dhe ose katalogun përkatës.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

Të tjera

OE është përgjegjës për sigurinë e punonjësve të tij dhe sigurimin e veshjeve personale mbrojtëse për realizimin e shërbimit.

OE është përgjegjës për çdo dëmtim të mjedisit dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi dhe të përdorin veshje të dukshme me tregues të qartë të emrit dhe ose logos së kompanisë.

Është përgjegjësi e OE sigurimi dhe paraqitja e dokumentacionit që provon kapacitetet e tij teknike lidhur me pajisjet që do të përdorë për realizimin e trajtimeve, metodologjinë e trajtimit, produktin larvicid që do të përdor, duke i listuar dhe përshkruar specifikimet teknike të përdorimit të tyre sipas habitateve të pritshme për trajtim dhe produkteve larvicide/biocide me të cilat parashikon të kryej trajtimin.

Gjithashtu, në ankesën e tij bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, pretendon se oferta e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK është anomalisht e ulët.

Në lidhje me operatorin ekonomik “RSM Company” SHPK, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon si më poshtë (citojmë):

“ - Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 11.07.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri